



**Republika e Kosovës**

Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës së Jugut**

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



<b>Datë:</b>	<b>31.12.2025</b>
<b>Për/Za/To:</b>	<b>z. Bedri Hamza</b> – Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut
<b>Nga /Od /From:</b>	<b>Gëzim Stavileci</b> - Drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme në Mitrovicën e Jugut
<b>Tema /Subjekat /Subject:</b>	<b>Raporti vjetor janar-qershor 2025</b>

**I nderuar,**

**Bedri Hamza** – Kryetar i Komunës së Mitrovicës së Jugut, Drejtoria për Administratë të Përgjithshme në kuadër të punëve të parapara sipas Rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësit e organeve komunale, më kompetencë dhe përgjegjësi ka përgatitur raportin e punës janar-dhjetor 2025, bazuar në nevojat dhe kërkesat e institucionit.

# Raporti i drejtorisë se Administratës Janar-Dhjetor 2025

## Qendra për Shërbim me qytetarë (QSHQ)

Nga data 01/01/2025 deri me 31/12/2025 në QSHQ janë pranuar dhe regjistruar gjithsejt 34707 lëndë.

Poashtu janë vulosur qindra dokumente dhe shkresa të lëshuara nga Komuna e Mitrovices së jugut.

## Spektori për punë të përbashkëta

### R A P O R T

#### Raporti vjetor i punës, Janar-Dhjetor/2025

Në kuadër të punëve dhe detyrave të parapara sipas Rregullores për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësit e organeve komunale, sektori për punë të përbashkëta me kompetenc dhe përgjegjësi ka realizuar pritshmërit dhe ka përmbushur detyrat e punës dhe përgjegjësit sipas fushave që mbulojnë njësit apo zyrat e këtij sektori.

Për periudhën që raportohet zyra për furnizim, është ballafaquar me pranimin e mallrave dhe shërbimeve duke kontaktuar me furnitorët për furnizim me artikuj me sasin e porositur, cilsin dhe vlerat e artikujve sipas kontratës për furnizim.

Kërkesa të realizuara .....444

Kërkesa për dorëzimin e mallit..... 444

Regjistrimi i lëndëve të njejta në programin mbi menagjimin e pasurisë.

Për kompletimin e lëndës deri te dorëzimi për pagesë, janë kryer veprimet si vijon:

- Kërkesa për blerje,
- Kërkesa për dorëzim,
- Pranimi i faturës sipas dërgesës së mallit dhe shërbimeve,
- Plotsimi i formularit për pranimin e mallit,
- Regjistrimi në librin e fatyrave hyrse,

-Kontimi i hyrjeve-dalje së mallit sipas programit e-pasuria

Zyra e verifikimit të dokumenteve;

Vërtetime për pensionist që janë në jetë për rregullimin e pensionit jashtë shtetit , lajmrimi, çlajmrimi i vendqendrimit , çertifikata të gjendjes ekonomike 510, Mbajtës i familjes 458, Dëshmi mbi vdekjen 480. Gjithsejtë numri i lëndëve të kryera 1448.

Shërbimi teknik;

Shtëpiaku-mirëmban objektin dhe hapsirat për rreth tij në baza ditore ,ka sanu prishjet e shkatuara në rrjetin e ujsjellësit, të kanilizimit, ka bërë pastrimin e pusetave, ka ndërhyrë në rrjetin elektrik, nxemja qendrore, mirëmbajtja dhe kontrollimi i tyre, riparime të vazhdueshme në nyjet sanitare në objektin e komunës dhe në zyrat e vendit, riparimi i tavolinave , karrikave, dyerëve dhe dritareve etj.

Fotokopja: Shumzimi i materialit për shërbime të kuvendit dhe organeve të tjera të Komunës.

Bën mirëmbajtjen-pastrimin në kontinuitet të fotokopjeve si dhe bën riparimin e prishjeve të vogla.

Shpërndarja e postes sipas destinacionit në adresë të përcaktuar nga dërguesi përmes librit të dërgesave, në kohën dhe vendin e duhur, duke u kujdesur në veçanti në ruajtjen e afateve ligjore.

Kamerat e vëzhgimit nuk janë në funksion, administrimi i aksesit në përcjelljen e zhvillimeve brenda dhe jashtë hapsirave të objektit të komunës, vëzhgimi i hyrje-daljeve është nën monitorimin e kompanisë për sigurimin fizik të objektit.

Sigurimi fizik i objektit dhe pasurisë të komunës, vëzhgimi i vazhdueshëm i hyrje – daljeve, regjistrimi në librin e kujdestarisë të çdo hyrje në objekt të personave pas orarit të punës.

## Sektori i Gjendjes Civile

Numri i certifikatave të lëshuara për përdorim të brendshëm prej dates  
01/01/2025 deri me 31/12/2025

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i certifikatës</i>	<i>Sasia</i>
01.	Certifikate e lindjes	4019
02.	Certifikate e martesës	3752
03.	Certifikate e vdekjes	4687
04.	Certifikate e Vendbanimit	858
05.	Certifikate e shtetësisë	85
06.	Status Martesor	1044
07.	Ekstrakt	25545
08.	Certifikate Familjare	4572
10.	Vërtetim nga Arkivi	497
11	TOTALI	45059

Numri i certifikatave të lëshuara për përdorim të jashtëm prej datës  
01/01/2025 deri me 31/12/2025

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i certifikatës</i>	<i>Sasia</i>
01.	Certifikate e lindjes	9665
02.	Certifikate e martesës	3776
03.	Certifikate e vdekjes	786
04.	Certifikate e Vendbanimit	1530
05.	Certifikate e shtetësisë	197
06.	Status Martesor	627
07.	Ekstrakt	9665
08.	Certifikate Familjare	1090
10.	Vërtetim nga Arkivi	367
11	TOTALI	24295

# Përkthimi i dokumenteve në Komunën e Mitrovicës – Janar – Dhjetor 2025

Shërbimi i përkthimit të dokumenteve

	Kuvendi dhe kryetari	Komitete	Zyra e Personelit	Nga drejtoritë	Përkthimi simultan
Janar	40		31	13	2:00
Shkurt	12		12	20	4:00
Mars	8		18	11	2:00
Prill	6		8	26	9:00
Maj	6		6	14	2:00
Qershor	2		2	25	5:00
Korrik	15		8	33	1:00
Gusht	2		12	4	1:00
Shtator	12		2	10	1:00
Tetor	9		3	18	3:00
Nentor	10		8	12	2:00
Dhjetor			15	10	3:00
	<b>122</b>		<b>125</b>	<b>196</b>	<b>35:00</b>

## Njësia komunale për të drejtat e njeriut

*Njësia komunale për të drejtat e njeriut (në vazhdim NJDNJK), është themeluar si një mekanizëm i qëndrueshëm dhe përgjegjës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel komunal, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe politikat e institucioneve të Kosovës.*

*Njësia Komunale për të Drejtat e Njeriut, adreson këto fusha:*

*Barazinë gjinore*

*Të drejtat e fëmijëve*

*Mundësitë e barabarta dhe kundërdiskriminimin*

*Përdorimin e gjuhëve*

*Të drejtat e komuniteteve*

*Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*

*Kundër trafikimin me qenie njerëzore*

Shënimi i Ditës Botërore të Shëndetit është organizuar një debat lidhur me të drejtat e njeriut të gjeneratës së dytë, me theks të veçantë të drejtat për sigurim dhe shërbim shëndetësor. Ndër të tjerat është diskutuar edhe çështja e ligjit mbi shëndetësinë dhe sigurimin shëndetësor, si dhe shërbimet shëndetësore publike primare dhe sekondare në komunën e Mitrovicës. Në debat janë ftuar përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si dhe gazetar.

Shënimi i Ditës Kombëtare të të Pagjeturve, është bërë në koordinim me shoqatën e familjarëve të personave të pagjetur me ç'rast janë vizituar shkolla në pjesën urbane dhe rurale të Mitrovicës dhe është organizuar ligjërata për shkëlqen e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare gjatë luftës së fundit në Kosovë si dhe për funksionimin e drejtësisë tranzicionale në kontekstin e Kosovës. Do të shtypet edhe një broshurë lidhur me shkeljet e bëra gjatë luftës së fundit ndaj qytetarëve të Mitrovicës dhe do t'u shpërndahet qytetarëve. Ligjërata në fjalë ka të bëjë me mbrojtjen ndërkombëtare që u bëhet personave që nuk marrin pjesë në konflikt, pra popullatës civile. Pra, gradualisht synohet të shtjellohet edhe ballafaqimi me të kaluarën. Nuk mund të ndërtohet e ardhmja pa u ballafaquar me të kaluarën dhe gabimi më i madh bëhet kur të rinjtë u sugjerohet të harrohet e kaluara. Pra, të rinjtë duhet të dinë çfarë ka ndodhur në të kaluarën, cilat të drejta dhe konventa janë shkelur e pikërisht këto do ta mësojnë përmes këtij ligjërimi i cili do të elaborojë këto tema:

- Nocioni i së drejtës ndërkombëtare humanitare;
- Historia e së drejtës ndërkombëtare humanitare;
- Parimet e së drejtës ndërkombëtare humanitare;
- Shkelja e të drejtës ndërkombëtare humanitare gjatë luftës në Kosovë;
- E drejta për të ditur fatin e personave të zhdukur sipas Konventave Ndërkombëtare;
- E drejta për të ditur sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës;

Shënimi i Ditës Botërore të Punëtorëve është organizuar një debat lidhur me të drejtat e punëtorëve në shoqërinë tonë, sukseset e arritura dhe sfidat me të cilat ballafaqohen punëtorët, respektimin e ligjit të punës, etj. Të pranishëm kanë qene përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që merren me të drejtat e njeriut, përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si dhe aktivistët e sindikatave.

Shënimi i Ditës Botërore të Diversitetit Kulturor është organizuar një debat lidhur me diversitetin kulturor dhe multikulturalizmin në shoqërinë tonë. Të pranishëm kanë qene përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që merren me të drejtat e njeriut, përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si dhe përfaqësues të bashkësive të ndryshme etnike.

Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve kemi vizituar shkolla në pjesën urbane dhe rurale të Mitrovicës dhe do të organizohen ligjërata për të Drejtat e Fëmijëve. Do të shtypet edhe një broshurë lidhur me të drejtat e fëmijëve e cila do të shpërndahet nëpër shkolla.

*Njësia për te Drejtat e Njeriut ka pasur dy aktivitete, aktiviteti i pare gjate muajit Korrik ka qene takime me zyrtaret e MAPL-se, rreth regjistrimit te komunitetit Rome, Ashkali dhe Egjiptian, si dhe aktiviteti i dyte ka qene takim ne Prishtine ne Hotel Sirius, i organizuar nga Zyra e Kryeministrit dhe Ambasada Italiane, rreth Sfidat dhe te arriturave te Personave me aftësi te kufizuar, si dhe plani i tyre ne një te ardhme te afërt.*

*Njësia për te drejtat e Njeriut është takuar me OJQ-ne, Sindrom Down, dega ne Mitrovice, ku qëllimi kryesor i këtij takimi ke bashkëpunimi edhe me tutje ndermeje kësaj OJQ-je, dhe Njesisë për te drejtat e njeriut.*

*Koordinatori i Njesisë se bashku me zyrtaren për barazi gjinore dhe me zyrtarin për komunitete, ne bashkëpunim edhe me Departamentin për te drejtat e njeriut ne Ministrin e Administrimit te Pushtetit Lokal, kemi vizituar dy lagje ne Komunën e Mitrovicës, ku jetojnë komuniteti Rome, Ashkali dhe Egjiptian.*

*Lagjet te cilat i kemi vizituar kane qene lagjja e Romeve dhe lagjja 2 Korriku, ku kemi biseduar me qytetar rreth projektit te regjistrimit falas për Komunitet Rome, Ashkali dhe Egjiptian.*

*Gjate bisedës me qytetar kemi vërejtur se disa qytetare te cilët janë nga komunat tjera por jetojnë ne Komunën e Mitrovicës nuk janë te regjistruar, ne Qertifikat e lindjes, dhe sa me pare te shkojnë ne Komunat e tyre qe te pajisen me këto dokumente.*

*Kurse ne lagjen 2 Korriku, i gjithë ky komunitet është i regjistruar dhe nuk ka problem me mjetet identifikues siç janë Letërnjoftimi, etj*

*Po ashtu edhe me zyrtaren për Barazi Gjinore, kemi vizituar edhe Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, e cila është qendër regjionale.*

*Ne ketë qendër jemi takuar me Fidane Hasani e cila na ka treguar rreth punëve dhe aktiviteteve te kësaj qendre, numrin e femrave te cilat kane qëndruar ne ketë qendër, numrin e fëmijëve qe kane qene ne ketë qendër.*

*Për momentin ne ketë qendër prezent ishin 3 femra duke u trajtuar nga stafi i kësaj qendre.*

*Ne si njësi i treguam për punët dhe pergjegjesite e qendrës si dhe angazhimin tone dhe përkrahjen e Njesisë për Organizata te cilat e kane mision dhe vizion te drejtat e njeriut*

*Gjithashtu jemi takuar edhe me OJQ-ne, Zëri i Prindërve, ku jemi pritur nga Bajram Qerkini dhe Xhylla Haziri, ku kemi biseduar dhe ju kemi treguar për aktivitetin te cilin do ta mbajmë me rastin e Dites Kombetare te Personave te Pagjetur, do te shkojmë dhe ti vizitojmë 30 gra te cilat i kane te zhdukur familjaret e tyre, ku ne do t'i dërgojmë nga një lule dhe do te bisedojmë me ato familjare për t;iu lesuar sado pak dhimbjet qe i kane për te dashurit e tyre.*

*Gjate muajit gusht , se bashku edhe me zyrtaren për barazi gjinore, kemi pasur takim pune me organizatën Save the Children, ne Prishtine.*

*Ne ketë takim jemi takuar me Rebeka Qena dhe Valid Zhubi, ku qëllimi i kiti takim ishte bashkëpunimi ndërmjet Njesisë për te drejtat e njeriut dhe Save the Children.*

*Biseduam rreth bashkëpunimit te Asamblesë se Fëmijëve ne Komunën e Mitrovicës, ku Save the Children, na ka përkrahe edhe rreth përzgjedhjes se nxënëseve ne ketë Asamble por edhe rreth aktiviteteve te përbashkëta dhe trajnime për këta fëmije te Asamblesë.*

*Unë si Koordinator i Njesisë për te drejtat e njeriut, e njoftova mbi punën te cilën e bene Njësia si dhe mbi aktivitetet qe është duke zhvilluar si dhe bashkëpunimet me OJQ-te, qe e kane si mision dhe vizion, mbrojtjen dhe promovimin e te drejtave te njeriut.*

*Si Koordinator kam pasur takime me Institucionin Avokatit te Popullit, zyrën Regjionale ne Mitrovice, ku qëllimi i këtyre takimeve është akordimin i përbashkëta ne realizimin disa projekteve ne Mbrojtjen dhe Promovimin e te drejtave te Njeriut.*

*Po ashtu zyrtarja për barazi gjinore ka pasur takim me OSCE, ne Mitrovices si dhe me Rrjetin e Grave te Kosovës.*

*Gjate muajit Shtator me Zyrtarin për Minoritet kemi marr pjese ne mbledhjen e Task-Forces për te drejtat e fëmijëve te organizuar nga Ter des hojmes, ku kemi shqyrtuar raportin te cilin e ka pregaditur Eksperti i Pavarur i angazhuar nga Terr des Homme.*

*Zyrtarja për barazi gjinore gjate kësaj jave ka pasur disa aktivitete me zyrën e USAIDIT, dhe me Agjensionin për Barazi Gjinore, ku qëllimi i këtyre takimeve ka qene avancimi i femrave ne vendimmarrje.*

*Po ashtu gjate muajit Shtator, eshte Miratuara edhe Rregullorja per strukturimin dhe themelimin e Asambleve te femijeve e Inicuar nga Njesia per te drejtat e Njeriut.*

*Gjate muajit tetor si Njesi per te drejtat e Njeriut kemi pasur disa aktivitetet dhe takime me organizata te ndryshme qe kane te bejne me mbrojtjen dhe promovimin ete drejtave te Njeriut, Java e Shkopit te Bardhe, me perfaqsesit e Shoqates se te verbereve, Muaji tetor mauji i mundesive te barabarta per personat me aftesi te kufizuar, etj*

*Gjate muajit nentor, njeri prej shume aktiviteteve ka qene edhe 32 vjetori i Konventes Nderkombetare per te drjetat e Femijeve, ku ne si Njesi per te drjetat e Njeriut se bashku me Asamblene e Femijeve dhe me Save the children kemi organizuar disa aktivitete te ndryshme ne kuader te kesaj date.*

*Po ashtu gjate muajit dhjetor me rastine Dites Nderkombetare te personave me aftesi te kufizuar, kemi pasur aktivitet, se bashku me OJQ-n, Handikos ne Mitrovice, ku kemi ligjeruar mbi te drejtat e njeriut e ne veqanti te drejtat e personave me aftesi te kufizuar, po ashtu edhe me 10 Dhjetor ne kuader te Deklerates Unviersale per te drejtat e Njeriut, une si Shef i Njesie per te drejtat e Njeriut, kame mbajture disa ligjerata ne Shkollat Fillore te Mesme te uleta te Komunes se Mitrovices.*

*Gjate ketij muaji ne si Njesi per te drejtat e Njeriut, kemi derguar edhe Rregulloren per te drejtat e femijeve te cilen e kemi punaur se bashku me KOMPF, ku kaluar ne Komitetin per politike dhe financa, dhe eshte aprovuar ne Kuvendin e Komunes, dhe ka dale ne degjim publike.*

*Fatkeqsisht gjete vitit 2025, edhe pse kemi pasur ne Nenkodin Buxhetor te Njesise per te drejtat e Njeriut 20.000 Euro(njezetmije Euro), keto mjete skemi mundur te bejme Thirrje Publike sepse te gjitha keto Mjete i ka marrur Permbaruesi Privat,ku skemi mundur ti shfrytzojne ne te miren e Organizatave Te Shoqeris Civile te cilat merren me mbrojtjen dhe promovimin e te drejtave te Njeriut, Femijeve, Komuniteteve dhe Personave me Aftesi te Kufizuar.*

## **Zyra e Teknologjisë Informative**

### **Raport Pune – (Janar – dhjetor 2025)**

Zyra për Teknologji Informative punëve të përditshme ka si Monitorimi I dhomës së SERVER-ave, Sistemit të menagjimit të palëve në Gjendjen Civile, Sistemin për menagjim dhe arkivim të dokumentave, sistemin e Intranetit, sistemin e vijueshmërisë në punë, ueb faqen, e- arkivën, e-pasurinë, Sistemin e BDMS në financa etj.

Zyra për Teknologji Informative ka në menagjim rrjetin në këto objekte : ATK, QKRC(te pasaportat), QRA(qendra e regjistrimit të automjeteve), DKRS, Enti I pensioneve, QPS, Mitrovica e veriut, Spitali regional Mitrovicë, Shtëpia e shëndetit, E-kiosku Tunel i Parë, ZGJ Shupkovc, E-kiosku Shipol dhe, ZGJC Spital, Patentë shoferet stacion i autobusëve, Burgu Veri, QPT ne veri etj.

Gjatë këtij viti kemi mbajtur 12 takime online dhe fizike në lidhje me Aplikacionin e Intranetit dhe E-komuna, gjithashtu kam asistue komunat ne veri për funksionalizimin e rrjetit shtetëror dhe Intranetit.

Janë krijuar llogari elektronike ne AD për zyrtar për shkolla dhe zyrtar te komunës dhe janë përditësuar shumë llogari elektronike për zyrtarët e QKMF-së për shkak se janë hapur qe tre vite dhe nuk janë përdorur asnjëherë dhe për zyrtarë tjerë.

Është mirëmbajete sistemi i radhës në QSHQ dhe Gjendje Civile, është krijuar share follderit dhe janë duke u krijuar çasje për secilin zyrtar ku do ti ketë shënimet e veta edhe në server.

Zyra e Teknologjisë Informative intervenimet primare I ka tek zyrtarët që kanë të bëjnë më palë si Gjendja Civile, QSHQ, Tatimi në Pronë, ARKA dhe Kadastri, për vitin 2025 ka kryer edhe këto ntervenime:

Nr.	Emri i drejtorise	Intervenimet
1.	Drejtoria e Administratës së Përgjithshme	1930
2.	Drejtoria Urbanizmit dhe Planifikimit Hapsinor	250
3.	Drejtoria per Shërbime Publike dhe Infrastrukturë	220
4.	Drejtoria e Shëndetësisë	320
5.	Drejtoria per Buxhet dhe Financa	450
6.	Drejtoria për siguri dhe Emergjenca	125
7.	Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë	450
8.	Drejtoria e Arsimit	120
9.	Zyra e kryetarit	103
10	Drejtoria per Kulturë Rini dhe Sport	75
11	Drejtoria për Integritet Evropiane dhe Zhvillim Ekonomik	35
12	Drejtoria e Inspektionit	350
13	Drejtoria per Mbrojtjen e Mjedisit	60
14	Drejtoria per Mirëqenie Sociale	540
15	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	72
Gjithësej:		5100